

18.08.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik: “aci engineering” shpk.**, me adrese Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Nderresa 8, Hyrja 13, Apartamenti 07, 1019, Tirane.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur pune mbi kufirin e lartë monetar” (me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-23133-03-25-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “F.V dhe Instalim te sistemit te Matjes Inteligjente ne Kabinat Elektrike te OSSH sh.a, SoftWare – t dhe integrimet e tyre ne platformen MDMS (Mater data mangement system”

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 43 datë 4 Prill 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒ X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë Ofertuesit si mëposhtë me vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “**aci engineering**” sh.p.k me nr. NIPT L51609014F me vlere oferte – 992,576,392.35 (Nenteqind e nentedhjete e dy milion e peseqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e nentedhjete e dy pike tridhjete e pese) leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “**ENCOAL**” sh.p.k me nr. NIPT L51531003F me vlere oferte – 1,038,802,841 (Nje miliard e tridhjete e tete milion e teteqind e dy mije e teteqind e dyzet e nje) leke pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “**GSA**” sh.p.k me nr. NIPT J61820031J me vlere oferte – 827,529,759.375 (Teteqind e njezet e shtate milion e peseqind e njezet e nente mije e shtateqind e pesedhjete e nente pike treqind e shtatedhjete e pese) leke pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “**H & E ENERGY**” sh.p.k me nr. NIPT L71716029A me vlere oferte – 1,030,725,787 (Nje miliard e tridhjetë milion e shtateqind e njezet e pese mije e shtateqind e tetëdhjetë e shtatë) leke pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik “**VIBTIS**” sh.p.k me nr. NIPT L02103503S me vlere oferte – 1,036,910,582 (Nje miliard e tridhjetë e gjashtë milion e nentëqind e dhjetë mije e pesëqind e tetëdhjetë e dy) leke pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit si mëposhtëm:

I. Operatorin Ekonomik “ENCOAL” sh.p.k pasi:

1. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit”, shkronja dh) ka kerkuar qe ofertuesi te deklaroje se nuk ka pagesa te pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Operatori Ekonomik “ENCOAL” shpk, nuk ploteson kete kerkese ligjore pasi nga verifikimi rezulton me kontribute shoqerore te pashlyera.

2. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7, pika 2, “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.1, shkronja “b”, ka kerkuar qe Operatori ekonomik duhet të paraqesë sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3.

Operatori Ekonomik “ENCOAL” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka dorezuar sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3.

3. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.2.1, ka kerkuar qe Operatori Ekonomik Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike duhet të paraqesë vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 524,088,353 (Pesëqind e njezet e kater milion e tetëdhjetë e tete mije e treqind e pesëdhjetë e tre) leke

Operatori Ekonomik “ENCOAL” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka dorezuar dokumentacion qe verteton se ploteson xhiron minimale te kerkuar.

4. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 ka kerkuar qe Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 209,635,341 (Dyqind e nente milion e gjashtëqind e tridhjetë e pese mije e treqind e dyzet e nje) leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit

të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 1.048.176.705 ALL (Një miliard e dyzet e tete milion e njëqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e pese) leke pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Operatori Ekonomik “ENCOAL” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk deshmon vleren minimale te puneve te ngjashme.

5. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.5 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese per listen e materialeve te meposhtme:

Panel Matje me TRI i TU perfshire SMART Meter dhe DCU.

Koncentratore i te dhenave dhe Mates Bilanci i integrueshem.

Kabllo TU me izolacion XLPE

Autorizim te prodhuesit / Distributorit te autorizuar per mallrat e mesiperme.

Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit / Distributorit te autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Distributor duhet te provoje lidhjen me prodhuesin.

Shenim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.

Ne menyre qe te krahasohet dhe te vleresohet pajtueshmeria me specifikimet teknike te kerkuara, OE/BO pjesemares duhet te paraqese tabelen e skedes teknike, e cila duhet te jete e plotesuar, firmosur dhe vulosur nga prodhuesi.

OE ENCOAL sh.p.k, nuk ploteson piken 1 dhe 4 te pikes 2.3.5 te Kapacitetit Teknik pasi, per produktet Mates dhe Koncentrator te dhenash nuk ka dorezuar Autorizim Prodhuesi dhe nuk ka dorezuar Tabelen e Skedes Teknike, e cila duhet te jete e firmosur dhe vulosur nga Prodhuesi.

6. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.6 ka kerkuar qe operatorët ekonomikë, ne ditën e hapjes se ofertave të dorëzojnë mostra të mallit (nga 1 cope), ”Mates Energjie Smart 3x230/400 V 5(6) A” dhe ”Koncentrator te dhenash 3x230/400 V” pasi e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Per sa mesiper, OE ENCOAL sh.p.k, nuk ploteson kete kriter pasi nuk ka dorezuar si muster koncentratorin e te dhenave, gjithashtu matesi i ofertuar dhe dorezuar eshte mates tre fazor per lidhje direkte dhe jo per matje te integruar me TRI sic kerkohet nga AK.

7. Ne Specifikimet Teknike, ne piken 7.2 ”Kerkesa te Pergjithshme”, AK eshte shprehur dhe kerkon qe kontraktorit te zgjeroje, perditesoje, zhvilloje me tej sistemin aktual duke perfshire si zgjerim e kapaciteteve fizike ashtu edhe aplikacionet, si dhe perditësimin e sistemeve operative ne menyre qe sistemi te permbushe funksionet e meposhtme.

OE ENCOAL sh.p.k, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka ofruar nje zgjidhje teknike per kerkesat qe lidhen me zgjerimin, perditësimin dhe shtimin e licensave per HES ekzistues.

8. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.6 ka kerkuar qe operatorët ekonomikë, ne ditën e hapjes se ofertave të dorëzojnë mostra të mallit (nga 1 cope), ”Mates Energjie Smart 3x230/400 V 5(6) A” dhe ”Koncentrator te dhenash 3x230/400 V” pasi e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

Per nje vleresim sa me transparent, Autoriteti Kontraktor, ne dt. 25.07.2022, ne prezence te perfaqesuesit te OE ENCOAL shpk dhe Komisionit te Vleresimit te Ofertave, jane mbledhur per testimin dhe komisionimin e mostrave te dorezuara nga shoqeria ENCOAL sh.p.k.

Nga ana e OSHEE GROUP sh.a, u krijuan te gjitha fasilitetet per vendosjen e sistemit te matjes, megjithëkete, nga ana e perfaqesuesit te ENCOAL shpk, u komunikua fakti se nuk mund te vijohet

me montimin e sistemit të matjes në mungesë të koncentratorit të të dhënave dhe se matësi është 5 (80) A në funksion për matje direkte dhe nuk e realizon skemën e matjes me TRI.

Për sa më sipër nuk u arit të vijohet me hapat e mëtejshëm si mëposhtë:

- Komisionimi i data – koncentratorit të të dhënave në platformën HES Aktuale.
- Detektimi i matësve nga data – koncentratori i të dhënave në platformën aktuale.
- Nuk u komisionua matësi në platformën HES Aktuale.
- Nuk u regjistrua matësi dhe data – koncentratori i të dhënave sipas të dhënave të kabines.

Per sa parashtruar më sipër, duke mbajtur në konsideratë pikën 6/a të nenit 40 të VKM 285, OE ENCOAL shpk nuk përmbush këto pike pasi materialet e ofertuara dhe mostrat e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e OSHEE GROUP sh.a.

II. Operatorin Ekonomik “GSA” sh.p.k pasi:

Autoriteti Kontraktor, në Dokumentat Standarte të Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.6 ka kërkuar që operatorët ekonomikë, në ditën e hapjes së ofertave të dorëzojnë mostra të mallit (nga 1 copë), ”Mates Energjie Smart 3x230/400 V 5(6) A” dhe ”Koncentrator të dhënash 3x230/400 V” pasi e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Për një vlerësim sa më transparent, Autoriteti Kontraktor, në dt. 26.07.2022, përfaqësuesit e Operatorit Ekonomik GSA shpk dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë AK, janë mbledhur për testimin dhe komisionimin e mostrave të dorëzuara nga shoqëria GSA sh.p.k.

Nga ana e OSHEE GROUP sh.a, u krijuan të gjitha fasilitetet për vendosjen e sistemit të matjes dhe në datën 26.07.2022 në orën 11:00, u njoftua Dispeceria për Stakimin e Fiderit të Kabines Vasil Shanto 3B, F327 dhe pas kësaj u vazhdua me:

- Montimin e matësve dhe koncentratorit të të dhënave në kabinën Vasil Shanto 3B.
- U konfigurua data-koncentratori me të dhëna (IP e serverit si dhe IP e data SIM karte) nga përfaqësuesi i GSA shpk dhe na u specifikua se është i nevojshëm upgrade i tij për marrjen e të dhënave të tjera.
- Propozimi teknik i bere nga GSA shpk nuk u realizua (lidhja data-koncentrator platforme).

Per sa parashtroam me siper, duke mbajtur ne konsiderate piken 6/a te nenit 40 te VKM 285, OE GSA shpk nuk permblush kete pike pasi materialet e ofertuara dhe mostrat e dorezuara nuk permblushim kerkesat e OSHEE GROUP sh.a. dhe konkretisht:

Matesi dhe Koncentratori i te dhenave i ofruar eshte IP53 jo IP54 sipas kerkesave ne piken 3.9.2 te Specifikimeve Teknike.

Referuar zgjidhjes teknike te ofruar nga Operatori Ekonomik, ku eshte ofertuar nje HES i ndryshem nga ai ne perdorim te OSHEE sipas kerkeses 2.2 te specifikimeve teknike, KVO nuk evidentoi ne dokumentacionin e ngarkuar asnje informacion lidhur me menyren e realizimit te zerave te kerkuar per perditimin, zgjerimin dhe shtimin e 10.000 licensave te reja ne HES ekzistues.

Gjithashtu sistemi HES i ofertuar nuk perfshin integrimin e matesave te ofertuar nga OE, pasi nga shqyrtimi i katalogut informues te Sistemit HES Zonus, ne listen e pajisjeve matese te homologuara me kete sistem nuk gjendet asnje produkt i prodhuesit El Gama matesi i te cilit eshte ofertuar dhe dorezuar si moster.

Gjate testimit te kryer per lidhjen e pajisjeve te dorezuara si mostra me sistemin HES ekzistues, pasi u krye montimi i mostres se dorezuar (matesit dhe koncentratorit te te dhenave), u konfigurua data-koncentratori dhe u verejt qe ai nuk merr te gjitha dhenat e kerkuara sipas specifikimeve teknike.

Propozimi teknik i ofertuar nga GSA Shpk nuk u realizua (lidhja datakoncentrator-platforme Zonus). As lidhja me HES – in ekzistues nuk u realizua.

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “GSA” shpk, nuk ploteson kerkesat dhe kriteret teknike te AK.

III. Operatorin Ekonomik “H & E ENERGY” sh.p.k pasi:

1. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.2.1, ka kerkuar qe Operatori Ekonomik Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike duhet të paraqesë vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 524,088,353 (Peseqind e njezet e kater milion e tetedhjete e tete mije e treqind e pesedhjete e tre) leke

Operatori Ekonomik “H & E ENERGY” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka dorezuar dokumentacion qe verteton se ploteson xhiron minimale te kerkuar.

2. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 ka kerkuar qe Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më

të vogel se 209,635,341 (Dyqind e nente milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e nje) leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 1.048.176.705 ALL (Një miliard e dyzet e tete milion e njëqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e pesë) leke pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Operatori Ekonomik “H & E ENERGY” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk deshmon vleren minimale te puneve te ngjashme.

3. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme), ISO 50000-1 ose ekuivalente, per standartin e menaxhimit te energjise dhe OHSAS 18001 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve / mallrave / shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Operatori Ekonomik “H & E ENERGY” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka dorezuar certifikate ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).

4. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.4 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues

për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. 1 (nje) Inxhinier Elektrik

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. 2 (dy) Inxhiniera Elektrike

- b. Mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, i punësuar me kohe të plote ose kontratë individuale të punës (per mjekun e punës të kontraktuar nga jashtë) dhe duhet të dorëzojë kontratën, cv, diplome dhe licence.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. 20 punonjësish, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshurara nga organe kompetente të akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- kartelat perkatese të sigurimit teknik
- Listepagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Shkurt 2022 të konfirmuara nga administrata tatimore
- Për inxhinierat pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mesiperme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si edhe diplomë + CV

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori Ekonomik “H & E ENERGY” shpk, nuk ploteson këtë pike pasi nuk ploteson nr. Minimal prej 20 punonjësish të kualifikuar me kartela të sigurimit teknik.

IV. Operatorin Ekonomik “VIBTIS” sh.p.k pasi:

1. Autoriteti Kontraktor, në Dokumentat Standarte të Tenderit, shtojca 7, pika 2, “Kriteret e Vecanta të kualifikimit”, pika 2.1, shkronja “b”, ka kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3.

Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk, nuk ploteson këtë pike pasi nuk ka dorëzuar sigurimin e ofertes, sipas Shtojces 3.

2. Autoriteti Kontraktor, në Dokumentat Standarte të Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më

të vogël se 209,635,341 (Dyqind e nente milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e një) leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 1.048.176.705 ALL (Një miliard e dyzet e tete milion e njëqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e pesë) leke pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk deshmon vleren minimale te puneve te ngjashme.

3. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme), ISO 50000-1 ose ekuivalente, per standartin e menaxhimit te energjise dhe OHSAS 18001 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve / mallrave / shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ka dorezuar certifikate ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).

4. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues

duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. N.P – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Klasifikimi – E
- b. N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Klasifikimi – A
- c. N.S – 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Klasifikimi – A

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Per operatoret e huaj te behet njesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit edhe Telecommunicationit ne plotesimin e licensave Profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.

Ne rast bashkimi operatoresh, licensat profesionale duhet ti paraqese operatori ekonomik sipas punimeve qe ka mare persiper, per te cilat kerkohet licensa.

Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk, nuk ploteson kete pike pasi licensa profesionale ne kategorine NP – 11, Klasifikohet A dhe jo pika E e kerkuar.

5. Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 7 “Kriteret e Vecanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.4 ka kerkuar qe Operatori ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- b. 1 (nje) Inxhinier Elektrik

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- c. 2 (dy) Inxhiniera Elektrike

- d. Mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, i punësuar me kohe të plote ose kontratë individuale të punës (per mjekun e punës të kontraktuar nga jashtë) dhe duhet të dorezojë kontraten, cv, diplome dhe licence.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- b. 20 punonjesish, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga organe kompetente te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- kartelat perkatese te sigurimit teknik
- Listepagesa e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per periudhen Shkurt 2022 te konfirmuara nga administrata tatimore
- Për inxhinierat pjese e stafit te cilet duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per periudhen e mesiperme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si edhe diplomë + CV

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk, nuk ploteson kete pike pasi nuk ploteson nr. Minimal prej 20 punonjesish te kualifikuar me kartela te sigurimit teknik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik aci engineering shpk me adrese Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Ndertesa 8, Hyrja 13, Apartamenti 07, 1019, Tirane se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 992,576,392.35 (Nenteqind e nentedhjete e dy milion e peseqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind e nentedhjete e dy pike tridhjete e pese) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra 100 është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.